

Prend BUZHALA:

ESTETIZMI I PËRVOJËS SË DASHURISË

(Në vend të recensionit)

Asnjë tip tjetër shkrimi, më mirë se teksti lirik, nuk arrin t'i shqiptojë ndjesitë e dashurisë. Këtë gjë dëshiron të na e vë në tryezën e leximit vëllimi poetik "Besa" (që ka një si moto paratekstuale "Ah, djeg në asht rrezatimi atyre syve...") të Besim Xhelilit. E si do të mund ta përshkruanin a shqiptonin magjinë e saj, kur dashuria është e tëra ndjesi, përjetim, thellësi e pasuri emocionesh? Gjuha e ARSYES e ka të pamundshme t'i gjejë fjalët, mu ashtu si është edhe vetë lirika e dashurisë, e cila është shprehje e botës së brendshme, shpirtërore. E, kur ballafaqohet me situatën emocionale për ta shprehur atë me anë të fjalës, poeti e pranon këtë fakt:

Truri më ka zënë pluhur

Veten nuk mundem ta gjej,

Më ka humbur fjalë e duhur

(poezia "Arsyeja")

I tërë ky vëllim poetik përbëhet nga lirikat e dashurisë dhe vjen si frymëzim përvojash a ndjesish. Lirika e ka një identifikim të shumëfishtë, shpesh dhe misterioz, me emocionin: ajo krijon lëvizje prej një situatë përjetimi në tjetrën. Nga shumësia e paanë e këtyre motiveve, emocioni i tillë lirik ndërlidhet më së shumti me bukurinë e ndjenjës së dashurisë.

1. Poezia e parë "Afshe ëndrrash"

(një lexim paradigmatic)

Nëse emocionet janë ato ndjesi a gjakime që nxisin kënaqësi apo dhimbje, nëse ato na e drejtojnë qenien tonë kah shtegu i një dëshire apo frike, atëherë nuk është e çuditshme pse shprehja lirike e pasuron hartën e këtyre përjetim-situatave në këtë vëllim poeti, herë me disponime të mahnitjes, mirësisë, zemërimit a dhembshurisë, herë si trazim dhe makth e herë si robërim erotik e rënkim përgjërues, apo si "pasion i shpirtit", si do të shprehej Dekarti; e, herë-herë, edhe me shpërfaqje të urrejtjes, xhelozisë, mospërfilljes:

*Besoj... unë zura ëndrrën që ecte si hyjneshë
Më erdhi zemërngrohtësi e mbiqiellit,
Robërova ëmbël ndjenjat...
Trazimet ikën me euforinë;
Eh, dëshirat ashtu sikur humbin
Unë rrugëve asgjësohem...
Shumë afsh rrëmbëu atë natë dy ëndërrimtarë,
Andej strehës hijet trishtuese
Ua mbyllën ëndrrave grykën!
Është zemëruar, oh, nata...*

Kështu shprehet poeti te poezia e parë. E pra, kjo ndjesi jo vetëm që është më e bukura, më e magjishmja, por ajo është tejhyjnore, mbiqiellore! Që në vargjet e para poeti përpiket që ta lartësojë përkushtueshëm si ndjenjë supreme, dhe, njëkohësisht, ta racionalizojë këtë emocion dashuror, si ëndërr-hyjneshë apo si zemërngrohtësi e mbiqiellit. Protagonistë të saj janë dy ëndërrimtarë. Ëndërrimtari personifikon modelet e përsosura, ideale, të lëndës së kënduar a të subjektit që i drejtohet. Dhe përplasjet idealitet-realist ndodhin aty për aty. Porse, aty ka ndodhë diçka, ka ndodhë një dramë jete, ku dy ëndërrimtarët humbin rrugëve të jetës! Ëndrra aty është ndërprerë nga hijet e jetës. Të duket sikur po e lexon një poemë-roman të tërë kushtuar dy ëndërrimtarëve në përpjekje për përafrim! Ndërsa folësit a subjektit lirik, i mbetet që ta ndiejë aq plagosshëm karakterin kalimtar të jetës, atë çastin e beftë të bukurisë së ndjenjës së tillë, ku evokimet aq të buta e aq të lëndueshme, vijnë me energjinë e dikurshme të përjetimit. Ato assesi nuk shqiten nga bota e përjetimeve, ato mbesin gjatë, si vulë robërimi. Aty këndohet dashuria e penguar, që humbi atyre rrugëve, por ndjesia e atij çasti mbetet i freskët.

Nuk i është shqitur kjo ndjenjë, sepse njeriu nuk ka se si të jetojë pa të; ajo mbushullon qenien e tij. Nga ana tjetër, a nuk është pikërisht universi i tillë i dashurisë ai që i fuqizon vlerat e përherëshme, ëndërrimin a fshehtësinë intime? Dhe, duke i fuqizuar amshueshëm këto vlera, a nuk e relativizon pikërisht ato të tjerat, që i takojnë karakterit kalimtar të jetës? Paradoksalisht, mbyllja e derës për këto vlera nuk ka mundur të ndodhë... sado që “është zemëruar nata!”

2. Energjia krijuese e dashurisë

Edhe lirikat në vijim ngërthejnë brenda vargjeve bukurinë e lëndimeve e të dramave të tilla emocionale, si e sugjeron edhe titulli i një poezie (“Poemth emocionesh”). Kësisoj, “Drithërimë e dashuri” jep pamjet e bukura lirike të paralelizmit figurativ të kohë-hapësirës (ditët, netët, vjeshta, gjethet, pemët, zogjtë e zi te pragun, pritja e mëngjeseve) dhe situatat emocionale me drithërimë e trazim (“*Rënkime pa fund. Më dhimbset kjo natë që ikën/ Një mike të bukur, që rri larg loti e futi gjallë në varr*”). Duke ligjëruar në veten e parë, poeti e intimizon më shumë këtë përjetim, pikërisht për faktin se është i merakosur e i preokupuar i tëri me qenien që do, për ta bërë sa më të lumtur atë, të bëjë diçka të mirë e të bukur. Ndryshe, as që mund të kuptohet dashuria, sepse, në këtë mënyrë, edhe e lehtëson dhe zbut lëndimin, ndarjen, largësinë, vuajtjen... gjakimin: “*Një çmenduri më kaplon sa herë që të shoh në sy.*”

Poeti lektiset pas femrës, Qenies-që do, për t’u mishërua plotësisht me të. Vargjet shpërndahen e thyhen në mënyrë asimetrike, të papërputhshme trajtash e përmasash, ritmesh e bosht-qëndrimesh, sepse, kësisoj, të gjitha lirikat duan të kenë shtrirje të plotë të emocionit. Mu ashtu si krijohet lëvizja e lirshme gjithë drithërimë, lëndime e lumturi e kësaj ndjesie...

Vargjet vijjnë si mundësi e frymëzimit të shumëfishtë: ato sugjerojnë këtë ndjesi, e cila e ndihmon subjektin lirik të dashurisë (a folësin lirik) që t’i rikthehet normalitetit, durimit, pritjes, shpresës, optimizmit, realizimit qenieplotë:

*Sot ndjehem pak më mirë, si i rilindur/
Asgjë nuk është e pamundshme.*

Duke e ndjerë fuqinë kreative të dashurisë, tek i lëviz dhe kufijtë e së pamundshmes, për të krijuar vlera të reja, kjo ndjesi dhuron dhe frymëzime të bukura poetike. Prandaj, dashuria është e tillë në secilën moshë të poetit (poezia “Ndjenja të vonshme”, “Rrugët e jetës”), duke i dhuruar secilën herë lëndimin e

bukur sfilitës (“*Kur veten në mes të jetës nuk mundet ta gjej*”); është ajo forcë lëvizëse që sjell lumturitë (poezia “*Ëndërr e lumtur*”), apo kur t’i dhuron edhe lëndimet e lektisjet (“*Rrugëve të pafundta*”). I faniten imazhet me shi veror, që sugjerojnë herë mërzinë e herë përmallimin, vijnë pamjet e thurjes së portretit, syve, gushës, flokut... Vijnë poezi që ligjërojnë për rrugët, netët, urat, ndjesitë, çastet, por edhe për mëkatin e dashurisë, absurditetin, fjalën... për gjithçka e thur këtë mikrokozmos dashurie. Dhe paradoksi i kësaj ndjesie nuk merr fund: në një rëndësi anë, ka kaq net e çaste mistike, kaq fshehtësi e mister të pashpjegueshëm, por asnjë ndjesi tjetër nuk është kaq universale dhe kaq e kuptueshme për secilën qenie të planetit (“*Ti do pushosh në fshehtësitë e mia*”).

3. Erosi, burim idealizimesh dashurore

Kurse poezia na ligjëron duke ndjekur zërin e brendshëm të zemrës. Gjithnjë e gjithnjë që nga fillimi, pa skaj, pa fund, ndjesi që nuk harxhohet asnjëherë. Me gjakim të përhershëm. Dhe sado që mosha vilet e harxhohet ndër vite, etja mbetet e pashuar. Nga burimet e saj njeriu ka nevojë të marrë e rimarrë vazhdimisht për ta ndërtuar, ngritur e realizuar qenien e vet. Sepse kjo është ndjenja më konstruktive që e mban jetën në këmbë. Është energjia më e mahnitshme që krijon drejtpeshimin e qenies dhe që e realizon të pamundurën:

Asgjë nuk është e pamundshme

Mjaft me veten gjithë jetën jam grindur

Ky drejtpeshim i mposht ato situata frike, apo mashtrimi, absurdi apo verbërie, apo qoftë edhe kur mbretërojnë gjendje të nivelit më të ultë të qeniesimit, si urrejtja, gënjeshtria, zemërimi apo egërsia. “Dashuria është meritore për shërimet mrekullibërëse” thotë Louise Hay. Poeti e fton këtë frymëzim që t’i mposhtë ndjesitë e tilla, qofshin ato edhe të lektisjeve apo lëndimeve shpirtërore, vetminë apo shqetësimet:

*Mjaft çdo natë je e vetmuar dhe e vrarë (...)
Doemos ti do vish në ëndrrën time,
Bashkë do jemi në buzëqeshje si kahera
Në puthje, dashuri dhe përjetime...*

Vijnë metaforat mbretërore që shënjojnë mbretërinë e këtij universi erotik. Vijnë vargje e lirika që ndonjëherë edhe i kapërcejnë protagonistët e dashurisë, për t'iu përshtatur ideve poetike, apo për ta kërkuar vizionin poetik, për shkak se dashuria e përsosur shkon edhe përtej qenies... deri te misteri mrekullibërës!

Ndryshe nga shumë poetë që shkruajnë të dehur nga erosi, pena e Besimit është e tujgur me lirizmin e mëndafshhtë, aspak të imponueshëm. Ai e estetizon përjetimin dhe dramën intime të dashurisë. Këndimi zhdrivillohet më shumë në frymë lirike-meditative. Aty ligjëron më shumë një Njeri i Përvojës së Dhimbjes së Dashurisë, që e kontrollon vargun poetik me racionalitetin e thënies poetike e jetësore:

*Unë e ti do të hapërojmë bashkërisht kohës përtej
Me krenari dhe zgjuarsi duke shpërndarë dashuri
(poezia "Besa")*

Së këndejmi, dhe erosi nuk është ai shkrimi dehës trup-shpirt, por një kërkim ku vetjet e dashuruara identifikohen plotësisht: *"Zemra i plas vajzës e gjoksi i gjëmon djalit."*

Besim Xhelili e pasuron edhe procedimorin poetik të diskursit të tij lirik. Kësisoj, folësi lirik, që ligjëron për ndjesinë e dashurisë nga një kënd intim, të drejtpërdrejtë, i drejtohet subjektit lirik, femrës, shpesh në veten e dytë, herën tjetër rrëfen në veten e parë, që na shfaqet njësi shpalim-meditim ndjesish. Erosi i tillë është një burim i pasur idealizimesh dashurore, burim fisnikërie e bukurie, ekstaze, vetëdijesimi, burim ndjesie që arrin majat e një fuqie kozmike...

Janar 2016